



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË INDUSTRIËS
DHE ENERGJISË

Nr. 5397/prot.

Tiranë, më 11.3.2018

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.1728, datë 08.10.2014.

SHOQËRISË "EDIL QUATRO" SH.P.K
Rruga e Durrësit, Pallati 118, Shkalla 2, apartamenti 9, Tiranë.

Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Bulevardi "Bajram Curri", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë.

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE
EMERGJENCAT NË MINIERA (AKSEM), ISH RISHIM
Rruga "Lord Bajron", Laprakë, Tiranë.

Shoqëria "Edil Quatro" sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1728, datë 08.10.2014, për mineral gur gëlqeror, në objektin "Damës", Fratar, Mallakastër", Qarku Fier.

Me shkresën e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) nr.6397, datë 20.07.2016, protokolluar në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.4845, datë 21.07.2016, me shkresën nr.5817, datë 27.07.2017, protokolluar në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.5397 datë 01.08.2017, është propozuar revokimi i lejes nr.1728, datë 08.10.2014, për mineral gur gëlqeror, në objektin "Damës, Fratar, Mallakastër", Qarku Fier, sepse nuk ka paguar garancinë financiare të rehabilitimit të mjedisit në shumën 522 000 lekë, siç është përcaktuar në nenin 31, pika 5, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, për vitet 2015 - 2016 dhe 2016 -2017; 2017-2018.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, për revokim, është i mbështetur në gërmën "ç", të pikës 1, të nenit 47 (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet), të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Për sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1728, datë 08.10.2014

për mineral gur gëlqeror, në objektin "Damës, Fratar, Mallakastër", Qarku Fier, që shoqëria juaj zotëron.

Ju vëmë në dijeni se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes nr.1728, datë 08.10.2014 për mineral gur gëlqeror, në objektin "Damës, Fratar, Mallakastër", Qarku Fier.

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI
DAMIAN GJIKNURI

NË MUNGESË DHE ME POROSI

ZËVENDËSMINISTRI

ENIS ALIKO

